



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES SHKUMBIN-DEVOLL

VENDIM

Nr. 5/1 date 30.09. 2010

Per

Miratim ne parim, te kerkeses per perdorim te rezerves ujore, me koncesion, per prodhim hidroenergjie, H/C "Topcias", ne kanalin vadites ekzistues "Hajdaraj – Topcias", "Naun Panxhi" Elbasan.

Ne mbeshtetje te neneve 8 dhe 21, pika c, te ligjit Nr.8093, date 21.03.1996 "Per rezervat ujore", Udhezimit te perbashket M.M.P.A.Ujrave e M.E.T.E. nr.727 dt.7.05.07. nr.3252 dt.02.05.07; V.K.M. nr. 27 date 19/01/2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncensioneve" kreu IV pika 1b; Vendimit nr. 87 date 16/01/2008 te K.M, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27. dt.19.01.2007 te K.M; VKKU nr.3 date 19.07.2002,"Per miratimin e rregullores te funksionimit te Sekretariatit Teknik te KKU, Keshillit te Basenit Ujembledhes dhe Agjensise te Ujit", Keshilli i Basenit Ujembledhes Shkumbin:

VENDOSI:

I. "Miratim ne parim" te kerkeses per perdorim te rezerves ujore, me koncesion, per prodhim hidroenergjie, h/c "Topcias", ne kanalin vadites ekzistues "Hajdaraj – Topcias", "Naun Panxhi" Elbasan .

Subjekti "DIETA" Sh.p.k.

II. Prurja mesatare e burimit uJOR, kuota absolute.

HEC – 1

Prurja respektivisht:

Qmes = 25 m³/sek.

Kuota, vepra e marjes respektivisht:

H= 114 m. absolute.

III. A.U.B Shkumbin te jape informacionin e nevojshem cdo aplikanti, per perdorim te Rezerves ujore, mbeshtetur ne V.K.M. nr. 27 date 19.01.2007.

IV. Uji per H.E.C do te perdoret vetem ne rastet kur nuk cenon nevojat e komunitetit per ujitje.

V. Ngarkohet A.U.B Shkumbin per ndjekjen e procedurave perkatese per zbatimin e ketij vendimi.

**A.U.B SHKUMBIN
PERGJEGJESI
Shaqir KUKA**



**KRYETARI KESHILLIT BASENIT
PREFEKTI QARKUT ELBASAN
Shefqet DELIALLISI**

